

KONTRATË PËR BASHKËFINANCIM ("KONTRATA") e lidhur më 30.10.2020 në mes

1 Fondacionit Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij - CHwB Kosova me qendër në Prishtinë, rr. Idriz Gijlani, nr. 4/9, nr të regjistrimit 5200385-7 dhe nr fiskal 601296818, e përfaqësuar nga Sali Shoshi, Drejtor Ekzekutiv, në vijim "Punëdhënësi" dhe / ose "CHwB Kosova" (në tekstin e mëtejme e referuar si Partner Kryesor)

2 Komuna e Gjakovës, e përfaqësuar nga Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës – (në tekstin e mëtejme e referuar si Bashkë-partner)

DUKE PASUR PARASYSH QË:

Palët dëshirojnë të specifikojnë ose t'i plotësojnë zotimet midis tyre duke i'u referuar investimeve të bëra krahas projektit "Zhvillimi i Rajonit Ekonomik Perëndim përmes Trashëgimisë Kulturore".

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Kontrate të Bashkëfinancimit është që të specifikojë detajet në lidhje me Marrëveshjen Kryesore (Memorandumin e Mirëkuptimit) të nënshkruar midis Palëve dhe Komunave të tjera të Rajonit Ekonomik Perëndim në shtator 2020, në veçanti në lidhje me organizimin e punës, menaxhimin e punës dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve lidhur ndër të tjera me përgjegjësinë, të drejtat e qasjes dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për projektin *Restaurimi i Kullës së familjes së Drane Bojaxhiut - Novosellë*.

Neni 2 Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe shkëputja e kontratës

2.1 Hyrja në fuqi

Një entitet bëhet Palë në këtë Kontratë për Bashkëfinancim pas nënshkrimit të kësaj Kontrate nga një përfaqësues i autorizuar.

Kjo Kontratë për Bashkëfinancim do të ketë fuqi nga Data e Hyrjes në Fuqi të theksuar në fillim të kësaj Kontrate të Bashkëfinancimit.

2.2 Kohëzgjatja dhe shkëputja e kontratës

Kjo Kontratë për Bashkëfinancim do të vazhdojë të jetë në fuqi dhe të ketë efekt të plotë deri në përmbushjen e plotë të të gjitha detyrimeve të ndërmarra nga Palët.

Neni 3 Përgjegjësitë e Palëve

Partnerët përcaktojnë me marrëveshje të përbashkët si Partner Kryesor **Fondacionin Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij - CHwB Kosova** dhe pajtohen që ky i fundit:

3.1 Është koordinator i të dy partnerëve që nënshkruajnë këtë Kontratë; Në veçanti, Partneri Kryesor do të:

- Harton planin komplet detaj për restaurimin e Kullës familjes së Drane Bojaxhiut;
- Harton detajet shtesë rreth implementimit të pozicioneve të financuara nga kjo marrëveshje bashkefinancimi;
- Zbaton intervenimet e parapara nga plani detaj në vlerë prej 20,000 EUR, specifikisht: 1. Rregullimi dhe/ose rindërtimi i mureve (8,000 EUR); 2. Ndërrimi i kulmit të ri (5,000 EUR); 3. Rregullimi i konstruksioneve meskatëshe (7,000 EUR).
- Monitoron që operacionet të zbatohen në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kryesore;
- Kujdeset që implementimi i intervenimeve të bëhet duke u bazuar në projektin detaj të intervenimeve;
- Mban përgjegjësinë për mbarëvajtjen dhe implementimin e procedurave të prokurimit për pjesën e financuar nga CHwB Kosova karshi implementimit të projektit;
- Siguron që promovimi të bëhet në përputhje me rregullat e organizatës për komunikim dhe promovim;
- Njofton menjëherë partnerët për çdo ngjarje që mund të çojë në ndërprerje të përkohshme ose përfundimtare ose ndonjë ndryshim tjetër në zbatimin e projektit;
- Nuk delegon asnjë ose një pjesë të këtyre detyrave tek bashkë-partnerët ose ndonjë entitet tjetër;
- Kontribuon financiarisht në projekt me shumat dhe specifikimet e dhëna në nenin 4.1;

3.2 Bashkë-partneri Komuna e Gjakovës, pranon të kryejë detyrat dhe detyrimet në vijim:

- Kontribuon financiarisht në projekt me shumën dhe specifikimet e dhëna në nenin 4.2;
- Zbaton intervenimet e parapara nga plani detaj i hartuar nga Partneri Kryesor në vlerë prej 10,000 EUR, specifikisht: 1. Rregullimi i dyerve dhe dritareve (5,000 EUR); 2. Vendosja e instalimeve (5,000 EUR);
- Cakton një koordinator të projektit për pjesët e projektit për të cilat është përgjegjës bashkë-partneri (aktivitetet dhe financat) dhe t'i jep atij/asaj autorizimin për të përfaqësuar Bashkë-partnerin në projekt;
- Mban përgjegjësinë për mbarevajtjen dhe implementimin e procedurave të prokurimit për pjesën e financuar nga Komuna karshi implementimit të projektit;
- Siguron qëndrueshmërinë e projektit pas përfundimit të projektit në përputhje me ligjet e aplikueshme;
- Njofton menjëherë Partnerin Kryesor për çdo ngjarje që mund të çojë në ndërprerje të përkohshme ose përfundimtare ose ndonjë ndryshim tjetër në zbatimin e projektit;

Neni 4 Financat

4.1 Partneri kryesor CHwB Kosova do të ndajë fondet në shumën prej 20,000 EUR sipas pozicioneve të parapara me nenin 3.

4.2 Bashkë-partneri Komuna e Gjakovës, do të ndajë shumën prej 10,000 EUR sipas pozicioneve të parapara me nenin 3.

Partneri Kryesor Fondacionit Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosova) është përgjegjës për zbatimin e procedurave të prokurimit gjatë zbatimit të projektit sipas pozicioneve të parapara në nenin 3 në shumën prej 20,000 EUR. Bashkë-partneri Komuna e Gjakovës, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të prokurimit gjatë zbatimit të projektit sipas pozicioneve të parapara në nenin 3 në shumën prej 10,000 EUR.

Neni 5 Personat Kontaktues

Mbikëqyrja e zbatimit të projektit *Restaurimi i Kullës së familjes së Drane Bojaxhiut - Novosellë* do të bëhet nga persona të përcaktuar nga të dy palët si më poshtë:

Partneri Kryesor Fondacionit Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosova) do të emërojë Adela Mekuli.

Bashkë partneri, Komuna e Gjakovës do të emërojë Besmir Hasi.

Neni 6

Shkëputja

Partneri Kryesor Fondacionit Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosova) mund ta shkëpus këtë Kontratë menjëherë në këto raste:

6.1 Bashkë partneri nuk arrin të përmbushë përgjegjësitë financiare sipas Nenit 4, duke dhënë një njoftim me shkrim një muaj më herët.

6.2 Zbatimi i politikës anti-ryshfet dhe anti-korrupsion të CHwB Kosova është kusht për këtë Kontratë. Çfarëdo shkelje e kësaj politike do të konsiderohet çështje serioze dhe mund të trajtohet nën procedurë disiplinore. Rastet e rënda mund të trajtohen si sjellje të pahijshme që çojnë në përfundimin e kësaj kontrate.

Për qëllimin e kësaj Klauzole: “**Praktikë e korrumpuar**” nënkupton ofrimin, dhënien, pranimin ose kërkimin e çdo gjëje me vlerë për të ndikuar dikë në procesin e prokurimit ose në kryerjen e Kontratës. “**Praktikë mashtruese**” nënkupton keqinterpretimin e fakteve me qëllim që të ndikojë në procesin e prokurimit ose ekzekutimin e kontratës në dëm të CHwB Kosovës, dhe përfshin praktikën konfliktuese ndërmjet tenderuesve (para ose pas dorëzimit të tenderit) të dizajnuara për të vendosur çmimet e tenderit në nivelet artificiale jo konkurruese dhe për të privuar CHwB Kosovën nga përfitimet e konkurrencës së lirë dhe të hapur.

6.3 Kjo Kontratë mund të shkëputet me marrëveshje të përbashkët midis të dyja Palëve duke dhënë një njoftim me shkrim një muaj më herët.

Neni 7

Pajtueshmëria

Kjo Kontratë e Bashkëfinancimit do të zbatohet në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës. Kjo Kontratë e bashkëfinancimit midis palëve nënshkruese nuk bie ndesh me asnjë marrëveshje tjetër të bërë me palët e treta paraprakisht.

Neni 8

Të ndryshme

Kjo kontratë do t'i nënshtrohet ligjit të Kosovës.

8.1 Në rast të një mosmarrëveshjeje nga kjo Kontratë, secila Palë mund të njoftojë me shkrim Palën tjetër ku referon mosmarrëveshjen në ndërmjetësim, duke përdorur një trupë të njohur ndërmjetësuese në Kosovë, që është e regjistruar në Komisionin Kosovar të Ndërmjetësimit dhe i licencuar nga Ministria e Drejtësisë së Kosovës.


8.2 Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i tillë i kërkesës për ndërmjetësim, Palët do të zgjidhin mosmarrëveshjen ose kërkesën që ka të bëjë me

Kontratën, duke përfshirë edhe shkëputjen ose vlefshmërinë e saj, nën kujdesin e Qendrës për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë (siç është specifikuar në Plan), në përputhje me rregullat e Arbitrazhit të Kosovës të aplikueshme të përdorura nga Oda e tillë 2.

Pas njoftimit të përmbajtjes së kontratës, kjo Kontratë u nënshkrua me mjete elektronike * dhe hyri fuqi nga Palët Kontraktuese në: 04.11.2020, në 2 kopje autentike, nga të cilat 1 kopje i përket secilës Palë Kontraktuese.

Nënshkruar nga:

Sali Shoshi
Drejtor ekzekutiv


Fondacionit Kosovar Trashëgimia
Kulturore pa Kufij - CHwB Kosova

Data: 06.11.2020

Nënshkruar nga:

Ardian Gjini
Kryetar i Komunës


Komuna e Gjakovës

Data: 06.11.2020

* Nënshkrimi elektronik për Kontratë do të zbatohet për të realizuar këshillat e distancimit social, në përputhje me rregulloren shtetërore në fuqi gjatë pandemisë COVID-19.